



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 155/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Nismës Qytetare për Ferizaj (NQF), për shkak të vendosjes së posterit në vend publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, kështu që Nismës Qytetare për Ferizaj (NQF), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.10.2013, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se kandidati për kryetar komune Bashkim Fazliu-Migjeni nga radhët e Nismës Qytetare (NQF), më datën 03.10.2013, në orën 10:00, në Ferizaj ka vendosur posterin e tij në shenjën e komunikacionit tek rrethrotullimi i rrugës Shkup-Prishtinë afër “HIB-Petrollit”, me të cilin veprim ka shkelur rregullat ligjore Rregulla 01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobjave neni 3 pika 2 si dhe Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike neni 4 pika b). Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi për shkeljen e supozuar.

PZAP-i, e informoi Nismës Qytetare për Ferizaj në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 04.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj kësaj nisme dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Anr. 155/2, PZAP-i, PZAP-i pranoi përgjigje në ankesë nga NQF në të cilën theksohet se: në momentin e marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesën Anr.155/2013 datë 04.10.2013, i kanë marrë të gjitha masat për evitimin e shkeljes së supozuar, duke e hequr posterin në fjalë të rrethi afër “HIB-Petrollit”. Në përgjigje të ankesës theksohet se si subjekti i ri dhe është hera e parë që garojnë në zgjedhje nuk kemi pas informata zyrtare se ku lejohen të vendosen posterat gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ngase në kemi menduar se posterat nuk lejohet të vendosen në institucionet publike dhe në nëpër objekte të bankave. Mëtej në përgjigje të ankesës theksohet se nuk kemi informata se

kush e ka vendosur posterin e NQF-së në vendin e palejuar siç pretendohet në ankesë. Ankesa e tillë e iniciuar sipas përgjigjes në ankesë ndaj një subjekti rival politik na vë në dyshime se situata të tilla mund të prodhohen dhe inskenohen në të ardhmen vetëm për të na bërë presion që të tërhiqemi nga gara.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur dy fotografi nga vendi ku kishte ndodhur shkeljen e supozuar dhe informatën që NQF-ja ju ka shpërnda nëpërmes facebook kandidatëve dhe mbështetësve të tyre në të cilën theksohet ndër të tjera se “Posteret nuk kemi të drejtë t’i ngjesim në Institucione Publike dhe Banka, pasi dënohemi”.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se panoja e kandidatit për kryetar komune të Bashkim Fazliu-Migjeni nga radhët e Nismës Qytetare (NQF) është e vendosur në shenjën e komunikacionit përkatësisht te rrethrotullimi i rrugës Shkup-Prishtinë afër “HIB-Petrollit”, e që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neni 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese dhe konstatoi se si rrethanë rënduese është fakti se posterin e NQF-së është vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave gjatë periudhës së fushatës zgjedhore siç e pranon edhe vetë shkelësi i supozuar në përgjigjen e tij në ankesë por i cili thekson se nuk ka qenë në dijeni se është i ndaluar një veprim i tillë dhe se nuk ka informacione se kush e ka vendos posterin në fjalë ndërsa si rrethana lehtësuese PZAP-i mori se shkelësi i supozuar (NQF) për herë të parë garon në zgjedhje dhe se e ka bërë përpjekje për evitimin e shkeljes së supozuar duke ofruar fotografi në të cilën shihet posterin në fjalë është larguar nga NQF-ja ku pretendohet në ankesë se ka qenë i vendosur.

Andaj, duke marr parasysh se nga ana e subjektit politik NQF është shkelur neni 3 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase nga dëshmitë që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se panoja e kandidatit për kryetar të komunës së Ferizajt nga radhët e NQF është vendosur në vendin e palejuar si dhe duke marr parasysh të gjitha arsyet e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 155/2013 më datën 05.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*